

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,
SEZONI 2023/2024
(java e pesëmbëdhjetë, deri më 14.04.2024)

TË DHËNA JAVORE


Gjatë javës së pesëmbëdhjetë të vitit 2024 (nga 08-14.04.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 145 (I=7,9/100.000) të prekur nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 5,2% më pak krahasuar me javën e kaluar (n=153).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit ta kaluar (n=82) është regjistruar një rritje prej 76,8%, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit (n=125) është regjistruar një rritje prej 15,7% (Grafiku 1).

Gjatë javës së pesëmbëdhjetë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV kanë arritur 30 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuara edhe për grip edhe për COVID-19. 3 raste kanë rezultuar pozitive: 2 Influenza B/Victoria dhe 1 Influenza B – linjë e papërcaktuar.

Incidenca e raportuar është nën kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=22,6/100.000) (Grafiku 1).

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024




Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 98 persona, nga 0-4 vjet –7, tek grupmosha nga 5-14 – 30 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 10 persona. Incidencë më e lartë (14,0/100.000) është regjistruar tek grupmosha nga 5-14 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë raportuar nga 13 QShP/NjR: Gostivar – 54, Shkup-25, Kavadar-23, ndërsa në të tjerat numri i rasteve të raportuara është më pak se 15.

Nga njësitë e raportimit që kanë raportuar raste gjatë kësaj jave në 11 është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 2 është regjistruar aktivitet sezonal i virusit të gripit (*Hartogrami 1*).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, jave e pesëmbëdhjetë 2024




МБИКËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - Të dhëna kumulative

Gjatë sezonit 2023/2024 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 14.788 (I=805,1/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=10.441) numri i rasteve të regjistruara është rritur për 41,6%, ndërsa krahasuar me modelin e 13 viteve të fundit (n=21.209) është regjistruar një rënie prej 30,3%.


Raste janë raportuar nga gjithsej 31 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (n=1.984) është regjistruar në QSHP Shkup ndërsa incidencë më e lartë kumulative (6.956,9/100.000) është regjistruar në Dibër.

Grafiku 2. Shpërndarja sipas QShP/NjR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 8.693 (58,8%), ndërsa incidencë më e lartë (1.843,1/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=1.779).


Grafiku 3. Shpërndarja sipas grupmoshës dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Shpërndarja e rasteve të gripit sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 1,3%
- nëntor – 268 raste ose 1,8%
- dhjetor – 829 raste ose 5,6%
- janar – 5.176 raste ose 38,7%
- shkurt – 6.373 raste ose 43,1%
- mars – 1.108 raste ose 7,5%,
- prill (do 14.04.2024) – 298 raste ose 2,0%.

Grafiku 4. Shpërndarja sipas muajve, sezoni 2023/2024



Deri më tani gjatë këtij sezoni janë regjistruar 14 raste të vdekjes si pasojë e gripit, nga Shtipi, Velesi, Kumanova, Negotina, Gostivari, Demir Hisari dhe Shkupi, 7 të grupmohës nga 15-64 dhe 7 mbi 65 vjet, të gjithë të hospitalizuar dhe të pavaksinuar kundër gripit sezonal, 12 prej tyre me komorbiditete. Tek 11 raste është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, tek 2 Influenza A – e pasubtipizuar, ndërsa tek 1 Influenza B/Victoria.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore) – Të dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e pesëmbëdhjetë, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 1.031 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuar janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç'rast janë detektuar 159 raste pozitive, 118 Influenza A(H1)pdm09, 12 Influenza A(H3) dhe 11 Influenza A – e pasubtipizuar, 16 Influenza B/Victoria dhe 2 Influenza B –linjë e papërcaktuar. Janë regjistruar edhe 20 raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar 29 raste me Virus Respirator Sincial (RSV).

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së pesëmbëdhjetë janë raportuar gjithsej 28 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga KU e sëmundjeve të fëmijëve (n=7; 25,0%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=9; 25,0%) janë raportuar në mesin e grupmohës 0-4 vjet dhe 30-64 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 182, pa raste në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 15,4% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 60,0% vihet re tek grupmosha 30-64 vjet.

Kumulativisht gjatë javës së pesëmbëdhjetë për analizë laboratorike kanë arritur 23 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, virusin sincicial respirator edhe për COVID-19. Në mostrat e analizuara në nga 1 mostër është vërtetuar Influenza B/Victoria, Influenza B – linjë e papërcaktuar dhe SARS-CoV-2. 20 mostra janë testuar për virusin sincicial respirator, pa raste pozitive.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 1.127 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (354; 31,4%) janë raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve Shkup. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=478; 42,4%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 5.555, nga të cilët 54 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 20,3% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 38,6% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Janë regjistruar edhe 14 raste të vdekjes, që i përkasin grupmoshës 30-64 vjet dhe mbi 65 vjet, me komorbiditete me Influenza A(H1)pdm09, Influenza A e pasubtipizuar dhe Influenza B/Victoria, ndërsa një me SARS-CoV-2.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 705 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në 79 mostra është vërtetuar Influenza A(H1) pdm09, në 24 Influenza B/Victoria, në 18 Influenza A(H3), në 6 Influenza A – e pasubtipizuar dhe në 5 mostra Influenza B – linja e papërcaktuar. Janë regjistruar 39 raste pozitive me COVID-19.

Nga mostrat SARI, 528 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 116 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është vërtetuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit. Në 3 mostra është vërtetuar prania e njëkohshme e Influenza A(H1)pdm09 dhe SARS-CoV-2.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE – të dhëna kumulative


Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e pesëmbëdhjetë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë në ISHP kanë arritur 1.738 materiale, që janë testuar për prani të virusit të influencës dhe SARS-CoV-2.

Janë zbuluar 291 raste me Influenza:

- Influenza A – 244 (83,8%)
 - Influenza A(H1)pdm09 – 197 (80,7%)
 - Influenza A(H3) – 30 (12,3%)
 - Influenza A – e pasubtipizuar - 17 (7,0%)
- Influenza B – 47 (16,2%)
 - Influenza B/Victoria – 40 (85,1%)
 - Influenza B – linja e papërcaktuar – 7 (14,9%)

Janë regjistruar 59 raste pozitive me SARS-CoV-2, 145 me (RSV) dhe 13 me viruse të tjerë respiratorë. Nga rastet me Influenza dhe COVID-19, tek 6 raste është vërtetuar infeksion i dyfishtë (“flurona”).

Grafiku 5. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes së rasteve pozitive me grip, RMV, 2023/2024



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rënie i numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili është në kuadër të aktivitetit jashtë-sezonal. Rezultatet e marra nga mbikëqyrja virologjike e gripit tregojnë përhapje lokale të virusit të influencës, ndërsa përqindja e rasteve pozitive është nën 10%. Sipas të dhënave nga mbikëqyrja SARI, numri i personave të hospitalizuar është më i ulët krahasuar me periudhën paraprake. Sipas këtyre të dhënave, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një përhapje gjeografike lokale dhe intensitet më të ulët të aktivitetit të virusit të gripit se sa në periudhën paraprake.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)

- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

4.500 vaksina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vaksina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2.644 persona.

Deri në javën e tetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 61.826 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e katërmëdhjetë të vitit 2024 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute të frymëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 7 nga 29 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit mbetet i shpërndarë gjerësisht, por po shënon një rënie të vazhdueshme. Aktiviteti i COVID-19 ka rënë këto muajt e fundit.
- Zbulimet e vërtetuara të infeksionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza B (68%) – të gjitha Influenza B/Victoria.
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëqyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është 7%.
- SARS-CoV-2 është në 1%.
- RSV ishte 4%.

Nga vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 1 vend ka raportuar për intensitet të lartë të virusit të gripit, 5 kanë raportuar intensitet mesatar, 10 të ulët dhe të tjerat intensitet bazë.

Nga vendet që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 9 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë, 9 - rajonale, 2 – lokale, 10 – sporadike.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive
Institutin e Shëndetit Publik

